



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

QERSHOR 2026

BULETINI MUJOR

MINISTRIA E MJEDISIT





Shqipëria merr Presidencën e FOREST EUROPE 2026-2030

Me mbështetjen unanime të 45 vendeve anëtare, Shqipëria merr Presidencën e FOREST EUROPE për periudhën 2026-2030, duke udhëhequr platformën pan-evropiane për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Ministri Jaupaj vizitë zyrtare në Suedi

Takim me homologun suedez në Stokholm: Shqipëria dhe Suedia zgjerojnë bashkëpunimin për mjedisin, klimën dhe zhvillimin e qëndrueshëm.



Liqeni i Shkodrës në UNESCO

Liqeni i Shkodrës hyn në hartën botërore të UNESCO-s si Rezervë Ndërkufitare e Biosferës, një vlerësim i jashtëzakonshëm për pasurinë natyrore dhe biodiversitetin e tij.



Rudina Hoxha vendoset në krye të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.

Rudina Hoxha është drejtoresha e re e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve. Me këtë emërim nis edhe një ridimensionim i rëndësishëm i rolit të Agjencisë, me përgjegjësi dhe kompetenca të zgjeruara.



Numri i vizitorëve në Zonat e Mbrojtura për periudhën Janar-Maj 2026

Interesi për zonat e mbrojtura të Shqipërisë vijon të rritet. Me mbi 1.5 milion vizitorë në pesë muajt e parë të vitit dhe një rritje prej 17%, natyra po kthehet gjithnjë e më shumë në një motor të turizmit të qëndrueshëm dhe zhvillimit lokal.



Bashkë për Aksionin Kombëtar të Mbjelljes së Pemëve

Së bashku me Ministren Ibrahimaj, në një tryezë me përfaqësues të biznesit për të bashkuar forcat në Aksionin Kombëtar të Mbjelljes së Pemëve. Një partneritet mes institucioneve dhe sektorit privat për një Shqipëri më të gjelbër dhe një të ardhme më të qëndrueshme.

Forcohet partneriteti mes Shqipërisë dhe OKB

Shqipëria dhe Kombet e Bashkuara nënshkruan Marrëveshjen Kuadër të Bashkëpunimit 2027-2031, duke forcuar partneritetin për mbështetjen e reformave, zhvillimit të qëndrueshëm dhe integritet europian.





Miratohet rregullorja CBAM

Qeveria miratoi rregulloret për autorizimin, monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, duke forcuar kuadrin ligjor për menaxhimin e emetimeve të karbonit.

Ky është një hap i rëndësishëm në përgatitjen e bizneseve shqiptare për mekanizmin CBAM dhe për vendosjen graduale të një çmimi të drejtë të karbonit.

BULETINI
MUJOR

QERSHOR 2026

